14901

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr 14901 VENDIMI

# V E N D I M
## PER REGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK

N e Tirane sot me date 10-5- 1996,une Gjyqtarja e Gjykates se rrethit Tirane M. Dedi mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesit Vasil Zumbuloglu dhe Nikollaq Neranxi per regjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "V A N I " shpk Tirane me seli ne Tirane ne rrugen " Muhamet Gjollesha " P. 73 ,kati I ,me dy ortake kerkuesit ,me administrator Nikollaq Neranxi ,me kapital themeltare lOO.OOO leke ,me kohezgjatje te veprimtarise deri te pakufizuar ,me objekt: Import -eksporti me shumice i mallrave te ndryeshme industriale ,ushqimore, produkte bujqesore e blegtorale , material ndertimi ,fruta perime ,etj.Prodhimi i artikujve ushqimore si (majoneze,leng limoni,mustarde,etj) si dhe import eksporti tyre.Import eksporti i te gjitha erezave.Importi i lendes se pare prodhimet e mishit ,sallamit,embelsirave,pijeve alkolike ,esencave e te tjera .Amballazhimi i te gjitha ketyre prodhimeve .

Eshte e drejte dhe si e tille duhet te pranohet

## PER KETO ARESYE

Ne baze te ligjit 7512 date lO.8.l991 dhe ligjit 7638 date l9.ll.l992 "Per shoqerite tregetare "

## V E N D O S A

Regjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " V A N I " shpk Tirane me seli ne Tirane ne rrugen "Muhamet Gjollesha" P.73. kati I,me dy ortake Vasil Zumbuloglu dhe Nikollaq Neranxi ,me administrator Nikollaq Neranxi ,me kapital themeltare lOO.OOO leke ,me kohezgjatje te veprimtarise te pakufizuar ,me objekt:
Import eksporti me shumice i mallrave te ndryeshme industriale , ushqimore, produkte bujqesore e blegtorale,material ndertimi,fruta perime ,etj.Prodhimi i artikujve ushqimore si (majoneze,leng limoni,mustarde etj.) si dhe import eksporti tyre.Import eksporti i te gjitha erezave.Importi i lendes se pare per prodhiemt e mishit,sallamit ,embelsirave ,pijeve alkolike, esencave e te tjera .Amballazhimi i te gjitha ketyre prodhimeve .

Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne shkallen e dyte .

GJYQTARE
Marjana Dedi

Tirelhei [illegible]

14901

1

2 a- Tani, Shpk.

b- Rr. " Muhamet Gjollesha " pT1, K.1. Tiranë

c- import eksport me shumicë, i mallrave të F. ushqimore, prodhim i artikujve import eksport i të gjitha llojeve. import eksport. ambalazheve. ....
Ambalazhim.

ç- 500 000 lekë.
Vasil Zumbuloglu. 50 %
Nikollaq. Nerantxi 50 %

3. Adm. Nikollaq Nerantxi dt. 1952
banon. Rr. Gimisqi Nr 73. Selanik.

4- 1 ..
Al - 2 flete
St - 6 flete

5. 13-5-96
10-5-96

[signature]

NIA 02759. Nr dg 17-0643-7121-00.

Leje higjeno sanitar. Nr 199 dt 14.5.96

# KONTRATE
## PER THEMELIMIN
## E
## SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
## " V A N I " SHPK TIRANE

---

Ne baze te ligjit 7512 date 10.8.1991"Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private,te nismes se lire dhe te veprimtarise private te pavarur dhe privatizimit" si dhe ligjit Nr.7638 date 19.11.1992"Per shoqerite tregetare"ortaket themeluese te shoqerise hartuan kete kontrate si vijon :

Sot me date 14.05.1996,ne Tirane ,ortaket e poshteshenuara hartuan kete kontrate themelimi te shoqerise " V A N I " SHPK me kushtet si vijon :

1. VASIL ZUMBULOGLU i biri Kostandinit ,lindur ne Ksanthi i datelindjes 3.6.1951, dhe banues ne Selanik Greqi ne adresen "RR. Cimisqi Nr.73 Selanik ,me Nr.pasaporte K 68254

2. NIKOLLAQ NERANXI i biri i Mihalit ,lindur ne Himare,me banim ne Greqi ne adresen "RR.Cimisqi Nr.73 Selanik,me Nr.pasaporte0252738

NENI 1

Te dy ortaket ,rane dakort te krijojne ne Shqiperi nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e cila do te veproje ne perputhje me legjislacionin shqipetare ne fuqi,dispozitat e kesaj kontrate ,dhe statutit bashkangjitur si dhe ligjit 7638 date 19.11.1992"Per shoqerite tregetare

NENI 2

Kjo shoqeri do te kete seline e saj ne SHqiperi ne Tirane,ne adresen : RRuga :" Muhamet Gjollesha ,P.71 kati I " dhe do te ushtroje veprimtarine e saj per nje kohezgjatje te pakufizuar .

NENI 3

Shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet qe nuk lidhen me veprimtarine e saj dhe nuk pergjigjet per veprimtarite e kryera me vehte nga ortaket e saj.Shoqeria pergjigjet plotesisht per te ardhurat e veta .

NENI 4

Shoqeria ka per objek te veprimtarise si me poshte vijon :

- Import eksporti me shumice i mallrave te ndryeshme industriale ushqimore, produket bujqesore blegtorale ,materiale ndertimi ,fruta perime e tjera .
- Prodhimi i artikujve ushqimore si ( majoneze, leng limoni, mustarde e te tjera ) si dhe import e eksporti tyre .
- Import eksporti i te gjitha erezave
- Importimi i lendes se pare per prodhimet e mishit ,sallamit, embelsirave,pijeve alkolike , esencave etjera .
- Amballazhimi i te gjitha ketyre prodhimeve

NENI 5

Emertimi i shoqerise eshte :" V A N I "SHPK
(me poshte do te referohet si shoqeri)

Kapitali themeltare i shoqerise eshte me vlere 100.000leke.Kapitali themeltare perbehet nga kontributet e meposhteme ne para :

1. VASIL ZUMBULOGLU kontribon me shumen 50.000 leke ose 50% te kapitalit themeltare
2. NIKOLLAQ NERANXI kontribon me shumen 50.000 leke ose 50% te kapitalit themeltare

Te gjithe pjeset e kapitalit themeltare te shoqerise jane te nenshkruara dhe te shlyera krejtesisht pastaj jane ndare ndermjet ortakeve .

NENI 6

Organi vendimor i shoqerise eshte Asambleja e ortakeve.Ortaket jane te detyruar te ruajne karakterin sekret te dokumentacionit e te eksperiences se shkembyer te realizuar brenda veprimtarise se shoqerise.

Shoqeria do te kete si Administrator te emeruar te saj Z. NIKOLLAQ NERANXI

NENI 7

Fitimi neto i realizuar nga shoqeria do te ndahet ndermjet ortakeve ne perpjestim me kontributin e tyre ne kapitalin themeltare te shoqerise.

Shoqeria fillon veprimtarine e saj private vetem pasi te kete marre lejen perkatese nga organet kompetente shqipetare te parashikuara nga legjislacioni shqipetare ne fuqi

Veprimtaria private e shoqerise eshte e mbrojtur nga shteti shqipetare ,i cili siguron kushte te njejta per te huajt si per personat juridike shqipetare.

NENI 8

Te gjitha mosmarreveshjet qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim do te paraqiten per zgjidhje ne gjykaten kompetente shqipetare te rrethit Tirane ne perputhje me legjislacionin shqipetare ne fuqi.

NENI 9

Dispozita te hollesishme percaktohen qarte ne statutin e shoqerise.Per sa nuk eshte shprehur ne kete kontrate do ti referohet per cdo ceshtje qe do te paraqitet, legjislacionit shqipetare ne fuqi ne Republiken e Shqiperise si dhe konkretisht ligjit 7638 date 19.11.1992"Per shoqerite tregetare" .

NENI 10

Kjo kontrate u redaktua ne 4 kopje ne gjuhen shqipe me te njeten fuqi dhe nenshkruhet rregullisht me vullnetin e plote dhe te lire te te dy ortakeve te shoqerise " V A N I " SHPK TIRANE.

ORTAKET THEMELUESE TE SHOQERISE
" V A N I " SHPK TIRANE

1. VASIL ZUMBULOGLU

2. NIKOLLAQ NERANXI

# S T A T U T
# I
# SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
# " V A N I " SH.P.K.

Ne mbeshtetje te ligjit Nr.7512 date 10.8.1991"Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private ,te nismes se lire dhe te veprimtarise private te pavarur dhe privatizimit"si dhe Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992"Per shoqerite tregetare", ortaket themelues te shoqerise hartuan statutin si vijon :

## K A P I T U L L I
## I

## FORMA,EMERTIMI,OBJEKTI,SELIA,DHE KOHEZGJATJA E SHOQERISE

### NENI I
### FORMA

Formohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar e ortakeve themeluese :
1. VASIL ZUMBULOGLU DHE 2. NIKOLLAQ NERANXI

### NENI 2

### EMERTIMI I SHOQERISE

Emertimi i shoqerise eshte " V A N I "sh.p.k.
(Me poshte do te referohet si shoqeri)

### NENI 3

### OBJEKTI I SHOQERISE

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte :

- Import - eksporti me shumice i mallrave te ndryeshme industriale, ushqimore, produkteve bujqesore blegtoraie ,material ndertimi ,fruta perime e tjera.
- Prodhimi i artikujve ushqimore si (majoneze ,leng limoni ,mustarde te tjera) si dhe import- eksporti tyre .
- Import eksporti i tegjitha erezave
- Importimi i lendes se pare per prodhimet e mishit ,sallamit, embelsirave,pije alkolike, esencave , e tjera.
- Amballazhimi i te gjitha ketyre prodhimeve.

### NENI 4

### SELIA

Selia e shoqerise eshte ne Republiken e Shqiperise ne adresen : RRuga Muhamet Gjollesha , P.71 , kati I . Tirane
Selia mund te ndryshoje me vendimin e Asamblese se ortakeve.
Veprimtaria e shoqerise do te kryhet brenda dhe jashte teritorit te Republikes se Shqiperise.Shoqeria ka te drejte te hape filiale ,dege ose zyra ne gjithe teriotorin e Republikes se Shqiperise si dhe jashte saj,gjithnje me vendimin e Asamblese se ortakeve.

NENI 5

KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Shoqeria do te kete nje kohezgjatje te veprimtaris se saj te PAKUFIZUAR.Shoqeria mund te riorganizohet ose te prishet ne cdo kohe me Vendimin e Asamblese se ortakeve.

K A P I T U L L I

II

KAPITALI THEMELTARE,KONTRIBUTET, TRANSFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT

NENI 6

KAPITALI THEMELTARE

Kapitali themeltare i shoqerise eshte me vlere: 100.000 leke.Kapitali eshte derdhur ne Banken Shqipetare ___________

NENI 7

KONTRIBUTET

Kapitali themeltare perbehet nga kontributet e ortakeve si vijon:
1. VASIL ZUMBULOGLU , kontribon me shumen 50.000 leke ose 50% te Kapitalit themeltare
Disponon 50 kuota duke filluar nga numri serise 1 deri 50

2.NIKOLLAQ NERANXI , kontribon me shumen 50.000 leke ose 50% te kapitali themeltare
Disponon 50 kuota duke filluar nga numri serise 51 deri 100
Kapitali themeltare i shoqerise eshte i ndare ne 100 kuota te barabarta me vlere nga 1000 leke secila,te renditura nga numri i serise 1 deri 100.,krejtesisht te shlyera.

NENI 8

TRANSFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT

Pjeset e kapitalit themeltare jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve.Pjeset e kapitalit themeltare mund tu transferohen te treteve vetem me miratimin e ortakeve dhe me kushte jo me te favorshme se ato me te cilat i eshte ofruar me pare ortakeve brenda shoqerise.

Pjeset e kapitalit themeltare jane lirisht te transferueshme me rruge trashegim.

K A P I T U L L I

III

KOMPETENCAT E MARRJES SE VENDIMEVE DHE TE ADMINISTRIMIT TE SHOQERISE

NENI 9

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Organ vendimor i shoqerise eshte Asambleja e ortakeve.

Asambleja e ortakeve vendos:

-Per bilancin vjetor
-Per ndryshimet ne statutin e shoqerise

-Per shtimin ose pakesimin e kapitalit themeltare te shoqerise
-Per emrimin e eksperteve kontabel
-Per pushimin e veprimtarise se shoqerise
-Percakton drejtimet kryesore te veprimtarise se shoqerise
-Per miratimin e planeve dhe llogarive ekonomike
-Per ndryshimin dhe emertimin e prodhimit
-Per treguesit e punes e financiare
-Per treguesit e transportit
-Per cmimet e shitjes
-Per strukturen administrative te shoqerise
-Per krijimin e fondeve rezerve,te zhvillimit,shperblimeve dhe ndihmes sociale
-Per krijimin e filialeve
-Per percaktimin e rregullores se brendeshme te shoqerise
-Per marrjen e kredive

Unanimiteti i vendimeve te perfaqesise se ortakeve eshte i nevojshem per keto ceshtje :

-Ndryshimet ne statutin e shoqerise
-Shtimi ose pakesimi i kapitalit themeltare i shoqerise
-Miratimi i kapitalit themeltare te shoqerise
-Miratimi i fitimit nga rezultatet e veprimtarise se shoqerise
-Zgjatja e kohes se veprimtarise se shoqeris
-Percakton drejtimet kryesore te shoqerise
-Per cmimet e shitjes
-Per strukturen administrative te shoqerise
-Per emrimin e Administratorit
-Per krijimin e fondeve rezeverve,te zhvillimit,shperblimeve dhe ndihmes sociale
-Per marrjen e kredive
-Per ceshtje te tjera,Asambleja e ortakeve vendos me shumice votash. Ne perfaqesim cdo kuote perfaqeson nje vote .

Cdo ortak ka te drejte te marre pjese ne mbledhjet e asamblese dhe disponon nje numer votash te barabarte me pjesen e kapitalit themeltare qe ai zoteron.Ne ushtrimin e te drejtes se vete per te marre pjese ne vendimet e Asamblese ,cdo ortak ka te drejte te perfaqesohet vete ose nga nje person i autorizuar prej tij me shkrim.Mbledhja e Asamblese se ortakeve mund te thiret se paku nje here ne vit duke lajmeruar me shkrim ortaket te pakten 15 dite me perpara,per kohen,vendin,dhe permbajtjen e mbledhjes.Mbledhja e Asamblese thirret nga njeri ose te ortaket,nga administratoret ose likujduesit.

## NENI 10

## ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Veprimtaria operative e shoqerise administrohet nga administratori i emruar, i cili merret me keto ceshtje :

-Organizon punen per realizimin e planeve te shoqerise dhe raporton per te para Asamblese se ortakeve te shoqerise
-Ne perputhje me programet dhe planet e pergjitheshme ,administron pasurine e shoqerise brenda caqeve te vendimeve te marra nga Asambleja e Ortakeve te shoqerise.

-Perfaqeson shoqerine para te treteve,ne gjykate e tj.
-Nenshkruan kontrata ne emer e per llogari te shoqerise dhe siguron venien e detyre ne jete
-Siguron drejtimin e shoqerise
-Perfaqeson shoqerine ne lidhje me te drejtat dhe obligimet e shoqerise me te tretet,sidomos per shlyerjen e kredive ne afat, brenda caqeve te objektit te veprimtarise se saj.
-Te siguroj zbatimin e sakte te vendimeve te Asamblese se ortakeve.

Ortaket bien dakort qe administratore te shoqerise emerohen :
1.NIKOLLAQ NERANXI i cili e pranon kete detyre .
Emerimi i tij behet me nje kohezgjatje prej 1 viti financiare me mandat te perseritshem ,me perjashtim te rasteve te doreheqjes ose shkarkimit te parakoheshem.
Administratori ka kompetence per te kryer te gjitha veprimet e administrimit ne interes te shoqerise dhe ne emer te saj nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e shoqerise.
Administratori eshte pergjegjes ndaj shoqerise ose ndaj te treteve qofte per shkelje ligjore,qofte per shkelje te statutit ose per faje te kryera prej tij gjate administrimit te shoqerise.

## K A P I T U L L I

## IV

### NENI 11

### VITI FINANCIARE,LLOGARITE VJETORE

Cdo vit financiare fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31.dhjetore te cdo viti.Llogarite vjetore,inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiare dhe raportet e vecanta te hartuara Administratori, miratohet nga Asambleja e ortakeve.

Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej 3 muajsh nga data e mbylljes se viti financiare

### NENI 12

### DIVIDENTET

Pas perfundimit te llogarive vjetore dhe evidentimit te ekzistences se fitimeve,Asambleja e ortakeve percakton pjesen qe u takon ortakeve ne formen e dividentit mbi fitim.

Fitimi qe do tu ndahet ortakeve ne proporcion me pjeset qe zoterojne ne kapitalin themelare,perbehet nga fitimi i vitit financiare te cilit i jane zbritur shumat e lena menjane per fondin rezerve te domozdoshem,per fondin e zhvillimit,ndihma e shperblime, dhe nga ana tjeter i jane zbritur ose i jane shtuar respektivisht humbjet nga fitimet e mbartura nga vitet e mepareshme.Cdo divident i ndare duke shkelur keto rregulla perben nje divident fiktiv dhe shoqeria mund te kerkojne kthimin e tij nga ortaku perftues brenda nje periudhe prej 3 vjetesh.

## K A P I T U L L I

## V

PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE DHE TERHEQJA NGA SHOQERIA

NENI 13

PRISHJA

Prishja e shoqerise behet me kushtet e permendura ne nenin 5 te ketij statuti ose per aresyet e parashikuara ne ligj

NENI 14

TERHEQJA NGA SHOQERIA

Cdo ortak ka te drejte te terhiqet nga shoqeria duke paraqitur kerkesen me shkrim 6 muaj perpara.Nga ky moment nuk gezon me te drejtat e shoqerise.Terheqja nuk i liron ortaket nga detyrimet materiale dhe financiare kundrejte shoqerise dhe te treteve.Detyrimet e shoqerise ndaj ortakut qe largohet likujdohen sipas vendimit te Asamblese se ortakeve, i cili merret jo me vone se nje vit nga data e paraqitjes se kerkeses per terheqje.

NENI 15

LIKUJDIMI

Shoqeria ne procesin e likujdimit ne momentin e prishje se saj per kryerjen e ketij procesi ,Asambleja emeron nje ose disa likujdues ,te cilet brenda nje afati prej 6 muajsh i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivit dhe pasivit te shoqerise mbi ndjekjen e operacioneve te likujdimit dhe mbi afatin e nevojshem te tyre .

Ne fund te procesit te likujdimit Asambleja e ortakeve vendos mbi bilancin financiare perfundimtare ,mbi aktin e likujdimit dhe mbi mbylljen e procesit te likujdimit.

Mbas pagimit te krediteve dhe shlyerjes se pjeseve te kapitalit themeltaretek kontribuesitperkates,likujduesi ndan kapitalet e mbetura ndermjet ortakeve me te njejtat proporcione me pjesmarrjen e tyre ne kapitalin themeltare.

K A P I T U L L I

VI

DISPOZITA TE FUNDIT

NENI 16

MARREDHENIET PER PUNESIM

Kriteret e pergjitheshme te punesimit te personave te tjere ,numrin e tyre ,kufijt e pagesave dhe detyrat e secilit ne shoqeri percaktohen me miratimin e orakeve.

Punesimi i personave ne shoqeri kryhet nga Administratori, mbi bazen e kontrates individuale te punes te hartuar sipas kodit te punes ne fuqi ne Republiken e Shqiperise .Kontrata firmoset nga punedhenesi dhe personi i punesuar .

NENI 17

RUAJTJA E INFORMACIONIT

Ortaket dhe te punesuarit jane te detyruar te ruajne ne cdo kohe konfidencialitetin e informacioneve mbi aktivitetin e shoqerise(sekretin e punes).Sekret pune paraqesin

shkresat, materialet dhe aktete te cilat ne baze te ligjes apo te vendimeve te nxjerra nga vete shoqeria jane shpallur sekret pune. Detyrimi per ruajtjen e sekretit vazhdon edhe pas largimit te tyre nga kjo shoqeri.

NENI 18

MOSMARREVESHJET

Te gjitha mosmarreveshjet ndermjet ortakeve ndermjet shoqerise dhe ortakeve ,ndermjet shoqerise dhe te treteve do te synohet te zgjidhen me mirekuptim.Ne raste te kundert do te paraqiten per zgjidhje gjykaten kompetente shqipetare te rrethit Tirane, ne perputhje me legjislacionin shqipetare ne fuqi .

NENI 19

Per sa nuk eshte shprehur ne kete statut i referohet Ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare" dhe per ceshtje te vecanta cdoligji perkates ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

NENI 20

Ky statut eshte hartuar ne 4 kopje ne Tiane,per tu dorezuar ne organet kompetente.Nje kopje e tij mbetet pjese e dokumentacionit te shoqerise " U A N I " shpk Tirane dhe nenshkruhet rregullisht nga ortaket themeluese te kesaj shoqerie.

TIRANE ,me date 14.5 .1996

O R T A K E T
THEMELUESE TE SHOQERISE
" U A N I "SHPK

1. VASIL ZUMBULOGLU

2 . NIKOLLAQ MERANXI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
NR 3206 REP NR 1558 KOL

U E R T E T I M

Vertetoj se sot me date 13.05. (nentedhjte e gjashte) ne zyren e noterise Tirane ,para meje notere ne kete qytet u paraqiten personalisht Vasil Zumbuloglu dhe Nikoliaq Meranxi ,me gjeneralitete dhe adrese sa siper.Per identitetin e tyre u sigurova nga pasaportat qe atat mbajne ,madhore me zotesi te plote per te kryer veprime juridike te cilet deklaruan se kane redaktuar jashte kesaj zyre me vullnet te lire kontraten dhe statutin e themelimit te shoqerise "VANI" shpk Tirane te cilen enenshkruan para meje kurse une noterja e vertetoj ate sipas ligjit rregullisht.

NOTERE

PULLE TAKSE
RpSHQIPERISE

## KERKESE

## PER REGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK

KERKUESIT / Ortaket e shoqerise "VANI" shpk Tirane

1. Vasil Zumbuloglu i biri i Kostandinit i datelindjes 3.6.1951,lindur ne Ksanthi,me banim ne Selanik Greqi ne adresen : RR. Cimisqi Nr.73 Selanik,me Nr.pasaporte K 68254
2. Nikollaq Neranxi i biri i Mihalit ,lindur ne Himare ,i datelindjes 10.1.1959 ,me banim ne Greqi ne adresen : RR.Cimisqi Nr.73 Selanik ,me Nr.pasaporte O252738

OBJEKTI / Ne baze te ligjit 7512 date 10.8.1991 dhe ligjit 7638 date 19.11.1992" Per shoqerite tregetare " kerkojme regjistrimin si person juridik te shoqerise se themeluar prej nesh te quajtur"VANI " SHPK Tirane

PERPARA GJYKATES SE RRETHIT TIRANE

ZOTI KRYETARE !

Ne baze te ligjit 7512 date 10.8.91 dhe ligjit 7638 date 19.11.1992 kemi vendosur te themelojme ne Shqiperi nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar "VANI" shpk me seli ne Tirane ne RR.M.Gjollesha P.73 kati I . Kapitali themeltare i shoqerise do te jete 100.000 leke ,kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte e pakufizuar. Ne te dy te nenshkruarit , do te jemi te dy ortaket e shoqerise te cilet kontribojme ne kapitalin e shoqerise me 50.000 leke secili. Administrator i shoqerise do te jete Nikollaq Neranxi ,objekti i veprimtarise se shoqerise eshte : -Import - eksport me shumice i mallrave te ndryeshme industriale ,ushqimore,produkte bujqesore , e blegtorale,material ndertimi,fruta perime,etj.Prodhimi i artikujve ushqimore si(majoneze,leng limoni ,mustarde, etj.) si dhe import eksporti tyre .Import eksporti i te gjitha erezave . Importi i lendes se pare per prodhimet e mishit,sallamit, embelsirave ,pijeve alkolike,esencave e te tjera Amballazhimi i te gjitha ketyre prodhimeve .
Lutemi nga ana juaj konforme kerkese sone te vendoset krijimi i shoqerise "VANI "shpk Tirane ku ne do te jemi ortake te saj

ME RESPEKT

KERKUESIT

1. Vasil Zumbuloglu    2. Nikollaq Neranxi

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
nR 3208 REP

### VERTETIM

Vertetoj se sot me date 13.05. 1996(nentedhjete e gjashte ) ne zyren e noterise Tirane para meje notere ne kete qytet u paraqiten personalisht Vasil Zumbulogu dhe Nikollaq Neranxi me gjeneralitete dhe adrese sa siper. Per identitetin e tyre u sigurova nga pasaportat qe ata mbajne ,madhore me zotesi te plote per te kryer veprime juridike te cilet deklaruan se kane redaktuar jashte kesaj zyre me vullnet te plote dhe te lire kerkesen per regjistrimin si person juridik te shoqerise "VANI" shpk Tirane , kerkese te cilen enenshkruan para meje kurse une noterja e vertetoj ate sipas ligjit rregullisht.

NOTERE